

Indeksi i volumit të shifrës së afarizmit

Indeksi i volumit të shifrës së afarizmit, vlerësuar me çmime fikse (2010=100) arriti 118,3 në tremujorin e dytë 2016.

Ndryshimi vjetor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum pasqyron rritje prej 0,3 % në aktivitetet ekonomike të mbuluara në anketë, krahasuar me tremujorin e dytë 2015. Ky ndryshim në të njëjtin tremujor të vitit 2015 ishte me rritje 1,9 %.


Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, në tremujorin e dytë 2016, paraqitet me rritje prej 10,1 % krahasuar me tremujorin e parë 2016.



Shërbimet

Në tremujorin e dytë 2016, ndryshimi vjetor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum në ndërmarrjet që operojnë në “**Shërbime**” shënoi rritje me 5,5 % **krahasuar me tremujorin e dytë 2015**, ndikuar kryesisht nga aktiviteti “Hotele” me 24,8 %.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum në aktivitetin “**Shërbime**” **në tremujorin e dytë 2016 krahasuar me tremujorin e parë 2016**, është rritur 12,2 %. Në këtë rritje ka ndikuar kryesisht aktiviteti “**Hotele**” me 64,0 %.

Ndryshimi Tremujor i Indeksit të Shifrës Së Afarizmit





Ndryshimi Vjetor i Indeksit të Shifrës Së Afarizmit

